

# UDHËZIME TË RËNDËSISHME PËR APELIMIN E VENDIMIT TË SEKSIONIT TË MBROJTJES SË REFUGJATËVE (SMR) QË KA JU KA HEDHUR POSHTË KËRKESËN

## **Mbushja dhe përgatitja e saktë e apelit**

### **Jo më larg se 15 ditë nga data kur keni marrë me shkrim arsyet për vendimin e SMR**

Duhet të plotësoni me shkrim Njoftimin për Apelim. Formulari i paplotësuar i Njoftimit për Apelim i është bashkangjitur këtyre Udhëzimeve të Rëndësishme.

- Tre kopje të Njoftimit për Apelim duhet t'ia dërgoni zyrës së Regjistrimit të Seksionit të Apelit të Refugjatëve. (Refugee Appeal Division (RAD) / Section d'appel des réfugiés (SAR)).
- Në Njoftimin e Apelit duhet të jenë të shënuar të gjithë personat që apelojnë bashkë me ju OSE Seksionit të Apelit të Refugjatëve i duhet dërguar një Njoftim Apeli për çdo person që e apelon vendimin.

### **Jo më vonë se 30 ditë pasi të keni marrë me shkrim arsyet për vendimin e SMR**

- Duhet të plotësoni të Dhënat e Apeluesit.
- Duhet të paraqisni dy kopje të të Dhënave të Apeluesit tek SAR
- Dokumentat dhe informacioni që duhen përfshirë në të Dhënat e Apeluesit gjenden tek Udhëzuesi i Apeluesit i cili gjendet tek <http://www.irb-cisr.gc.ca/Eng/RefApp/Pages/RefAppKitTro.aspx>

**Ju lutem vini re: Në qoftë se e plotësoni Njoftimin për Apel pas afatit kohor për të plotësuar të Dhënat e Apellantit, ka rrezik që apeli të mos iu merret parasys.**

## **Kërkesat për shtyrje afati për plotësimin e formularit:**

### **Shtyrje afati për plotësimin e të dyjave, Njoftimit për Apel dhe të Dhënave të Apeluesit**

Po të mos arrini dot t'i plotësoni në kohë Njoftimin për Apel dhe të Dhënat e Apeluesit, duhet t'i dërgoni Seksionit të Apelit të Refugjatëve një kërkesë për shtyrje afati. Në kërkesë duhet të paraqisni arsyet e vonësës. Kërkesa për shtyrjen e afatit duhet të ndjekë rregullat 6 dhe 37 të Rregullave të Seksionit të Apelit të Refugjatëve. Bashkë me kërkesën duhet të paraqisni tre kopje të Njoftimit të Apelit dhe dy kopje të të Dhënave të Apeluesit. Gjithashtu do t'iu duhet edhe një dëshmi ose deklaratë statutore në mbështetje të kërkesës.

### **Shtyrje afati për plotësimin e të Dhënave të Apeluesit**

Në rast se e keni dorëzuar në afat Njoftimin e Apelit por nuk arrini dot të dorëzoni në kohë të Dhënat e Apelit, atëherë duhet t'i dërgoni një kërkesë për shtyrje afati Seksionit të Apelit të Refugjatëve. Në këtë kërkesë duhet të paraqisni arsyet e vonësës. Kërkesa për shtyrjen e afatit duhet të ndjekë rregullat 6 dhe 37 të Rregullave të Seksionit të Apelit të Refugjatëve. Bashkë me kërkesën duhet të paraqisni dy kopje të të Dhënave të Apeluesit. Gjithashtu do t'iu duhet edhe një dëshmi ose deklaratë statutore në mbështetje të kërkesës.

## **Ku dërgohen dokumentet e apelimit**

Dokumentat duhet t'ia dërgoni zyrës së Regjistrimit të Seksionit të Apelit të Refugjatëve që ka të njëjtën adresë me zyrën e Regjistrimit të Sektorit të Mbrojtjes së Refugjatëve që jepet në njoftimin për vendimin që iu ka ardhur.

### **Këshilltar Ligjor**

Për t'iu ndihmuar me apelin ju mund ta shihni të arsyeshme marrjen e një këshilltari ligjor. Nëqoftëse këshilltari ligjor iu kryen shërbime me pagesë, ose me forma të tjera shpërblimi, atëherë ai/ajo duhet të jetë anëtar i regjistruar i një shoqate ligjore të provincës (juristë apo noterë), të Dhomës së Noterëve të Kuebekut (Chambre des notaires du Québec), ose të Këshillit Rregullator të Këshilltarëve të Imigracionit të Kanadasë (Immigration Consultants of Canada Regulatory Council / Conseil de réglementation des consultants en immigration du Canada). Nëse këshilltari nuk iu kërkon pagesë, atëherë duhet të plotësoni formën e titulluar Shënim për Përfaqësim pa Pagesë apo Shpërblime të Tjera (Notice of Representation Without a Fee or Other Consideration / Avis – représentant non rémunéré ni autrement rétribué) dhe t'ia paraqisni atë sa më shpejt që të jetë e mundur Ministrit ose Seksionit të Apelit të Refugjatëve. Ky formular gjendet tek faqja elektronike e BRI (shihni më poshtë)

Po patët këshilltar, atëherë përgjegjësinë për t'u siguruar që këshilltari respekton afatet e keni ju.

### **Gjuha**

Dokumentin e Apelit mund ta merrni dhe ta plotësoni në njërën nga gjuhët zyrtare të Kanadasë (anglisht ose frëngjisht) që dëshironi. Çdo dokument tjetër në gjuhë tjetër duhet dorëzuar së bashku me përkthimin në anglisht apo në frëngjisht, si edhe me një dëshmi të nënshkruar nga përkthyesi që vërteton se përkthimi është i saktë.

Te *Udhëzuesi për Apeluesin i cili gjendet tek faqja elektronike e BRI*, do të gjeni informacion për zgjedhjen midis anglishtes dhe frëngjishtes dhe për të kërkuar përkthyes simultan nëqoftëse apeli iu kërkon një seancë gojore dëgjimi.

### **Informacioni juaj mund të përdoret edhe nga organizata të tjera**

Informacioni vetjak që do të paraqisni gjatë procesit të apelit mbledhet nën autoritetin e Aktit të Imigrimit dhe Mbrojtjes së Refugjatëve (*Immigration and Refugee Protection Act / Loi sur l'immigration et la protection de réfugiés*) me qëllim që apeli juaj t'i paraqitet për vendim Seksionit të Apelit të Refugjatëve. Informacioni juaj vetjak mund të përdoret edhe nga organizata të tjera, duke përfshirë Agjencinë Kanadeze të Shërbimeve Kufitare (Canada Border Services Agency / Agence des services frontaliers du Canada), Ministrinë e Qytetarisë, Refugjatëve dhe Imigracionit të Kanadasë (Immigration, Refugees and Citizenship Canada / Immigration, Réfugiés et Citoyenneté Canada), Shërbimin Informativ për Sigurinë të Kanadasë (Canadian Security Intelligence Service / Service canadien du renseignement de sécurité), si dhe agjencitë e zbatimit të rendit, me qëllim administrimin dhe zbatimin e Aktit të Imigrimit dhe Mbrojtjes së Refugjatëve.

**Të dhëna të mëtejshme dhe akses te versionit elektronik \*të Paketës së Apeluesit në lidhje me formularët gjenden tek :**

<http://www.irb-cisr.gc.ca/Eng/RefApp/Pages/RefAppKitTro.aspx>.

Akses në Rregullat e Seksionit të Apelit të Refugjatëve (Rregullat e SAR) mund të gjendet në Departamentin e Drejtësisë, Kanada faqja elektronike [laws-lois.justice.gc.ca/eng/regulations/SOR-2012-257/index.html](http://laws-lois.justice.gc.ca/eng/regulations/SOR-2012-257/index.html)

*\*Nëse nuk keni akses në printer, ju lutemi të paraqiteni në një nga zyrat më të afërta te BRI (shih informacionet e kontaktit me poshtë) për të siguruar një kopje të Paketës së Apeluesit.*

Të dhënat për të kontaktuar Zyrat e Seksionit të Apelit të Refugjatëve (SAR)

**Zona Lindore**  
**(MONTREAL)**  
Zyra e SAR  
Bordi i Refugjatëve dhe i  
Imigracionit  
Guy-Favreau Complex  
200 René-Lévesque boulevard  
WEast Tower Room 102  
Montréal (Québec) H2Z 1X4  
Telefon: 514-283-7733  
ose 1-866-626-8719  
Faks: 514-496-6629

**Zona Qendrore**  
**(TORONTO)**  
Zyra e SAR  
Bordi i Refugjatëve  
dhe i Imigracionit  
74 Victoria Street, Suite 400  
Toronto, Ontario M5C 3C7  
Telefon: 416-954-1000  
ose 1-866-790-0581  
Faks: 416-954-1511

**Zona Perëndimore**  
**(VANKUVER)**  
Zyra e SAR  
Bordi i Refugjatëve  
dhe i Imigracionit  
300 West Georgia Street, Suite 1600  
Vancouver, British Columbia V6B 6C9  
Telefon: 604-666-5946  
ose 1-866-787-7472  
Faks: 604-666-9870